

SHENIMET E PEDAGOGUT

TEMA 1: Hyrje ne Analizen Financiare

A. Hyrje

Analistet jane pjese integrale e disa funksioneve, por pergjithesisht vleresojne investimet ne disa tipe letrash me vlere sic jane aksionet dhe obligacionet. Per te arritur nje vendim investimi ose ne rekomandime per investime analisti duhet te vleresoj performancen, pozicionin financiar si dhe vleren e kompanise qe i emeton letrat me vlere. Raportimi financiar i kompanise i cili perfshin pasqyrat financiare dhe te dhena te tjera ofrojne informacionin e nevojshem per te vleresuar kompanine dhe letrat e saj me vlere. Si rrjedhim, analisti duhet kuptoje permbytjen e raportimit financiar dhe si ato i perqasen realitetit ekonomik.

Pasqyrat financiare perpilohen duke u mbeshetur ne raportimin selektiv te ngjarjeve dhe duke zgjedhur nje metode te caktuar kontabile. Duke qene funksion i ketyre elementeve ato japin perafersim te realitetit ekonomik.

- Qellimi i Analizes se Pasqyrave Financiare

Roli i raportimit financiar eshte te jape informacionin e nevojshem rreth performances, pozicionit financiar, dhe ndryshimeve ne pozicionin financiar te cilat jane te nevojshme per nje numer te madh perdoruesish te cilet bazuar ne kete informacion marrin vendime ekonomike. Roli i analizes se pasqyrave financiare eshte te marre informacionin financiar te pergatitur nga kompania ta kombinoje ate edhe me informacionit tjetere te nevojshem, duke vlersuar keshtu te performancen e kaluar, performancen aktuale si dhe te parashikoje te ardhmen e kompanise. Rezultatet e ketij vlersimi ndihmojne ne marrjen e vendimeve te investimit, kreditimit dhe vendimeve te tjera ekonomike.

Analiza e pasqyrave financiare gjithmone behet kur kemi nevoje te marrim nje vendim ekonomik. Shembuj te vendimeve ekonomike te cilat e kane te nevojshme analizen e pasqyrave financiare jane.

- Vlersimi i nje aksioni nga ana e investitorit me qellim futjen e tij ne portoro
- Vlersimin e nje kompanie kandidate per nje shkrirje apo blerje
- Vlersimi i nje nenfiliali apo dege e cila eshte nje divizion operacional i kompanise me
- Percaktimi i cilesise se kredise per nje kompani qe ka kerkuar borxh
- Dhenia me shume kredi nje klienti te caktuar
- Ekzaminimi i zbatuesmerise se konventave te borxhit
- Vendosja e nje grade te caktuar borxhit qe hemeton nje kompani
- Parashikimi i te ardhurave dhe fluskseve te parase se ardhme

Ka disa ceshtje te cilat mbulohen nga analiza financare, por ne pergjithesi analistet kerkojne te ekzaminojne performancen dhe pozicionin financiar aktual te kompanise si dhe te parashikojne performancen dhe pozicionin e ardhem financiar te kompanise. Analistet gjithashtu jane te interesuar edhe rreth faktoreve qe ndikojne tek risku i performances dhe pozicionit financiar te ardhshem te kompanise. Ekzaminimi i performances mund te perfshije vlersimin e aftesise se kompanise per te gjeneruar fitime , si dhe vlersimit te aftesise se kompanise per te gjeneruar flukse te parase. Fitimi dhe flusket e parase nuk jane identike . Ndryshimi midis tyre rrjedh nga zbatimi i parimit te kontabilitetit rrjedhes kur pergtisim raportimin financiar Fitimi perfaqeson diferencen midis cmimit te te mirave dhe sherbimeve te shitura dhe kostove totale te ofrimit te ketyre te mirave dhe sherbimeve (pavarsisht nese parate jane arketuar ne rastin e te ardhurave apo paguar ne rastin e kostove). Megjithese fitimi eshte shume i rendesishem edhe aftesia per te gjeneruar flukse paraje pozitive eshte po aq e rendeshishme . Fluksi i parase eshte i rendeshishem sepse parate jane te nevojshme per te paguar punonjesit furnoret etj , ne menyre qe kompania te vazhdoje pune. Nje kompani qe gjeneron flukse paraje pozitive nga operacionet ka me shume fleksibilitetet ne plotesimin e nevojave per investime shtese , ka mundesi te perfitoje nga oportunitetet e biznesi atraktive . Gjithashtu flukset e parase jane burim i kthimit tek ofruesit e kapitalit . Keshtu qe niveli I flukseve te pritshme te parase eshte i rendesishem ne vlersimin e letrave me vlere te kompanise dhe ne pecaktimin e aftesise se kompanise per te perbushur detyrimet. Aftesise per te permbushur detyrimet afat-shkurtra i referohemi me termin likuditet, dhe aftesise per te permbushur detyrime afat gjata i referohemi me termin aftesi paguese (solvency). Gjithsesi sic tregohet ne shembujt 1 . fluksi i parase ne nje periudhe nuk eshte nje mates i plote i performances se periudhes ; per shembull kompania mund te kete shtyre pagesat e tanishme per me vone dhe kjo rezulton ne flukse pozitive aktuale. Sic e theksuam dhe me larte fitimi tregon aftesine e firmes per te ofruar sherbime dhe te mira me cmime me te larta se kostoja e tyre. Fitimi gjithashtu jep informacion te rendesishem rreth flukseve te pritshme dhe te shkuara te parase.

Paneli A : Marre nga informacioni financiar i Apple

Raporti i rezultateve te tremujorit te Trete

Kaliforni – Korrik 19, 2006. Apple sot beri publike rezultatet e tremujorit te trete te vitit fiskal 2006 qe mbaroje ne 1 korrik , 2006. Kompania ka te ardhura totale 4,37 bilion dollare dhe nje fitim neto te tremujorit 472 milion . Ne te njejtin tremujor nje vit me pare Apple kishte te ardhura totale 3,52 bilion dollare dhe fitim neto 320 milion dollare Marzhi bruto ishte 30.3% nderkohe qe nje vit me pare ishte 29.3% . Shitjet nderkombetare zinin 39% te shitjeve totale te ketij tremujori.

Apple shperndau 1,327,000 Macintosh Computers dhe 8,111,000 Ipods vetem kete tremujor duke pasur nje rritje 12% ne Mac dhe 32% ne Ipods krahasuar me po te njejtin tremujor nje vit me pare.

Paneli B: marre nga CNET News Report

Te ardhurat ne tremujorin e trete te Apple Computer kane rritur lehtesisht nga ato qe priteshin por perfitueshmeria ishte me larte sec pritej dhe shitjet e Mac jane rritur.

Te ardhurat neto ishin 472 milion dhe fitimi per akion ishte 54 cent duke u rritur

me 48% krahasimisht me fitmin per aksion ne po te njejtin tremujor nje vit me pare. Analistet kane pritur te ardhura rreth 4,4 billion dhe fitim per aksion 44 cent. Prognoza e te perjudhes se ardhme ndoshta do te zhgenjeje disa investitore. Kompania ka parshikuar te ardhuar tremujorin e katert rreth 4,5-4,6billion nderkohe qe analistet kishin parashikuar 4,9 billion.

B. Fokusi ne Vendimet Investuese

Klasat e perdoruesve. Konceptet dhe teknikat e analizes financiare te prezantuara ne kete kurs, perdoren nga:

- Investitoret: Kreditoret dhe investitoret ne aksione.
- Qeveria: Autoritetet Rregullative dhe Mbikqyrese dhe Zyra e Tatimeve.
- Te tjere: Publiku i gjere, grupet e interesit, punonjesit, etj.

Llojet e ndryshme te investimit.

Llojet e investimit ndryshojne ne menyren se ku mbeshtetet vendimarrja per investimin ne:

- Investim Intuitiv i cili mbeshtetet ne intuite dhe jo ne analize te mirefillte. Investitori mbeshtetet ne gjykimin e tij subjektiv ne intuite dhe jo ne konkluzione qe dalin nga nje analize e mirefillte e kompanise e cila ka emetuar investimin e zgjedhur.
- Investim Pasiv. Pranon cmimin e tregut si vlere. Keto investitore duke perdorur analizen teknike e cila bazohet ne menyren se si kane ecur cmimet e letrave me vlere ne treg per te parashikuar levizjet e ardhshme te tyre.
- Investimi Fondamental, i cili sfidon cmimet e tregut. Duke u bazuar ne elementet e analizes fundamentale e cila analizon percaktoret kryesore te vleres se kompanise qe emeton letrat me vlere investitori mund qe te shmange letra te vlere te cilat nuk jane te mirevleresuara. Hasen dy tipe te investimit fondamental:
 - Investimi Aktiv
 - Investimi Mbrojtes.

Rreziqet e cdo menyre investimi

- Rreziqet ne menyren Intuitive:

- ✓ Mashtrim i vetvetes: Injorohet aftesia per te kontrolluar intuiten
- Rreziqet ne menyren Pasive:
 - ✓ Cmimi eshte cfare ju paguani, Vlera eshte cfare ju merrni.
 - ✓ Risku per te paguar me shume nga cduhet.
- Analiza Fondamentale
 - ✓ Kerkon pune!
Maturia kerkon analize: nje mbrojtje kunder pageses se cmimit te gabuar (ose shitjes me cmim te gabuar).
 - ✓ Investimi mbrojtës
Aktivizmi kerkon analize: Nje mundesi per te gjetur investime qe nuk jane mirevleresuar.

Analiza e Raporteve Financiare te kompanise eshte nje mjet i cili perdoret gjeresisht per nje matje krahasuese te kthimit dhe riskut te kompanive per marrjen e vendimeve kryesisht investuese dhe kredituese.

Investitore te ndryshem i bazojne vendimet e tyre te investimit ne rezultatet qe dalin nga analiza financiare e kompanise.

Parimet Baze ku Mbeshtetet Analiza Financiare e Kompanive

- Kur blen nje aksion blen nje biznes.
- Kur blen nje biznes duhet ta njohesh ate.
- Vlera varet nga modeli i biznesit dhe strategjia.
- Firmat e mira mund te jene blerje te keqija.
- Cmimi eshte cfare ti paguan. Vlera eshte cfare gjen.
- Pjese e riskut ne investim eshte risku qe te paguash me shume sesa duhet per nje aksion.
- Mos miksoni cfare ju dini me spekulimin.
- Bazoni vleresimin ne cfare ju dini dhe jo ne spekulim.
- Kur llogarit vlerat per ti krahasuar me cmimin, ji i vetedijshem per perdorimin e cmimit ne llogaritje.
- Qendro tek besimet e tua dhe ji i duruar; cmimet bien, por per kete mund te duhet kohe.

Risqet qe shoqerojne nje investim

Risqet qe shoqerojne nje investim jane risku baze dhe risku i cmimit:

- Risku baze eshte risku qe rezulton nga operacionet e biznesit.
- Risku i cmimit eshte risku i tregimit me cmimin e gabuar.

- ✓ Te paguash me shume
- ✓ Te shesesh per me pak

Te vleresosh riskun baze i cili rezulton nga operacionet e biznesit eshte pjese e redeshisme e analizes financiare te nje kompanie analize e cila fillon me analizen e biznesit. Nje analist duhet te kuptoje mire biznesin gje e cila konsiston ne:

- Te kuptojme modelin e biznesit (strategjia).
- Te njohim mire detajet.

Nderkohe qe pasqyrat financiare jane lentet me te cilat shikojme biznesin.

Kuptohet qe analiza qe i behet nje biznesi varet nga qellimi ose objekti i analizes.

Zakonisht kemi analiza te jashtme dhe analiza te brendshme.

❖ **Analiza e jashtme** (kryhet nga nje analist i jashtem) duhet te fokusohet ne vleren e firmes dhe te keshilloje investitoret. *Analisti i jashtem vlereson vleren e firmes.*

- *Analisti i aksioneve* objektivi i te cilit eshte te vleresoje aksionet potenciale per investim te percaktoje nese aksioni eshte atraktiv dhe cili mund te jete cmimi i blerjes se ketij aksionit. Fokusi i vleresimit perqendrohet tek potenciali fitimprures afatgjate, norma e rritjes, dhe aftesia per te paguar dividente.
- *Analisti i Kredise* (borxhit). Objektivi i te cilit eshte vleresimi i aftesise kredituese te kompanise ne termat e kredidhenies si dhe klasifikimi i kredise. Ne rastin e borxhit afatshkruter analisisiti fokusohet mbi aftesite likuiduese te kompanise. Nderkohe qe analiza e borxhit afatgjate fokusohet mbi efikasitetin e aktiveve afatgjata dhe potencialin fitimprures.

❖ **Analisti i brendshem** vlereson planet e brendshme te investimit te firmes me qellim gjenerimin e vlerave per firmen. Analisti i brendshem vlereson strategjite e firmes dhe zakonisht eshte ne funksion te menaxhimit te kompanise.

Gjithsesi analistet mund te jene te perfshire dhe ne te tjera detyra te ndryshme nga keto te permendura me siper, sic eshte vleresimi i performces se nje filiali te kompanise, vleresimi i nje investimi privat ne aksione, ose te gjejne aksione te cilat mund te jene te mbivleresuara per te marre pozicione short.

C. Te investosh ne nje biznes

Investimi ne kompani jane vlerat qe i jepen kompanise nga investitoret ne tregun primar te kapitalit: kompania shton ose humbet ne vlere dhe vlere i kthehet

investitoreve. I gjithë informacioni mbi vlerat e investuara si dhe vlerën e realizuar nga kompania gjendet në Pasqyrat Financiare dhe elementet e tjera të raportimit financiar. Investitorët tregtojnë në tregun sekondar të kapitalit bazuar në informacionin që marrin nga Pasqyrat Financiare.

Te investosh në një biznes duhet të njohim aktivitetet baze të biznesit të cilat janë:

- **Aktivitetet Financiare:** Te arketosh para nga investitorët dhe të paguash para tek investitorët.
- **Aktivitetet Investimi:** Te investosh para të mbledhura nga investitorët ose të arketosh para nga shitja e aktiveve në mjete kryesisht afat gjatë.
- **Aktivitetet Operacionale:** Përdorimi i mjeteve për të prodhuar dhe shitur produkte, dhe shërbime.

Emetimi i obligacioneve dhe aksioneve të kompanisë janë transaksione të cilat përfshihen tek aktivitetet financiare të kompanisë. Vlerat rrjedhin nëpërmjet tregut primar nga investitorët tek kompanitë.

Kompania paratë e arketuara nga investitorët i përdor për blerjen e mjeteve afat gjatë, transaksione të cilat përfshihen tek aktivitetet investuese.

Një pjesë e vlerave të hyra në kompani nga investitorët përdoren në aktivitetet operacionale sic është blerja e lëndës së parë apo pagesat e ndryshme që lidhen me shitjen dhe prodhimin e të mirave dhe shërbimeve.

Transaksionet ekonomike regjistrohen në kontabilitet duke përfutur pasqyrat kryesore financiare të një kompanie.

D. Informacioni Baze Financiar.

Outputi i procesit kontabel është një grupim pasqyrash financiare, shënimesh shoqëruar dhe informacion shtesë. Në qendër të strukturës së raportimit financiar është objektivi i tyre: *një prezantim i drejtë* i:

- ❖ Pozicionit financiar të kompanisë,
- ❖ Performancës financiare të saj,
- ❖ Si dhe rrjedhjes së flukseve të parave në kompani.

Për një prezantim të drejtë të pozicionit financiar të kompanisë si dhe performancës financiare të saj pasqyrat financiare mbështeten në parimin rrjedhës dhe supozimin që firma është një shqetësim i vazhdueshëm.

- ❖ **Parimi rrjedhes**, kerkon qe transaksionet te reflektohen ne pasqyrat financiare kur ato ndodhin dhe jo domosdoshmerisht kur levizjet e vlerave monetare ndodhin. Per shembull kompanite raportojne te ardhurat kur ato njihen pavaresisht faktit nese kompania i ka arketuar ose jo parate.

- ❖ **Shqetesim i vazhdueshem** i referohet supozimit qe kompania do te vazhdoje biznesin ne nje te ardhme te parashikueshme. Per shembull krahasoni vleren e inventarit te nje kompanie **duke supozuar** se inventari mund te shitet brenda nje kohe normale kundrejt vleres se inventarit nese supozohet se inventari duhet te shitet brenda nje dite ose nje jave. Kompanite te cilat mendohen se do te likuidohen ose duhet te shkurtojne konsiderueshem aktivitetet e tyre do te kerkonin supozime te tjera per paraqitjen e drejte te realitetit te tyre ekonomik.

Pasqyrat baze jane:

1. Bilanci tregon cfare zoteron kompania dhe cfare detyrohet ajo ne nje moment te caktuar kohe dhe quhet ndryshe edhe pasqyra e pozicionit financiar. Pozicioni financiar i nje kompanie pershkruhet ne termat e aktiveve, detyrimeve dhe kapitalit te vet:

- *Aktivet (A) jane burimet e zoteruara (kontrolluara) nga kompania si rrjedhim i ngjarjeve te shkuara dhe nga pritjet te rrjedhin perfitimet e ardhshme ekonomike te kompanise.*

- *Detyrimet (L) perfaqesojne detyrimet e kompanise qe kane rrjedhur si pasoje e ngjarjeve te shkuara, shlyerja e te cilave rezulton si nje fluks dales te perfitimeve te ardhshme ekonomike te kompanise.*

- **Kapitali i vet (E)** Gjeresisht i njohur si kapitali aksioner, percaktohet duke zbritur nga totali i aktiveve detyrimet e kompanise dhe matematikisht tregohet me ekuacionin e meposhtem: **A=D+KV** ose **A-D=KV** Kapitali mund te shikohet si nje pretendim i mbetur pasi kompania eshte e detyruar fillimisht te shlyeje detyrimet dhe obligimet qe rrjedhin nga ato, para se te permbushe pretendimet e aksionereve te saj.

Cdo transaksion qe hyn ne kontabilitet matet dhe ekuacioni thelbesor i bilancit permban:

$$\text{Aktive} = \text{Detyrime} + \text{Kapitali i Vet}$$

$$\text{Ose}$$

$$\text{A} = \text{D} + \text{KV}$$

Vlera e kapitalit te vet (vlera e aksioneve) varet nga saktesia e matjes se detyrimeve (borxhit) dhe aktiveve.

Matja eshte procesi i percaktimit te shumes monetare me te cilen elementet e detyrimeve dhe aktiveve do te njihen dhe do te mbahen ne bilanc. Alterantivat e meposhtme perdoren ne shkalle te ndryshme dhe ne kombinime te ndryshme ne matjen e aktiveve dhe detyrimeve.

- *Kosto historike*, eshte thjesht shuma e mjeteve monetare ose ekuivalenteve ne para te paguara per te blere nje aktiv duke perfshire kostot e blerjes dhe pergatitjes. Nese aktiv i nuk eshte blere ne para kosto historike eshte vlera e drejte e cfaredo qe eshte dhene per te blere mjetin. Kur i referohemi nje detyrimi matja me kosto historike i referohet shumes se mjeteve monetare te marra ne shkembim te detyrimit.
- *Kosto aktuale*, duke ju referuar aktivitet, eshte shuma e mjeteve monetare ose ekuivalenteve ne para qe mund te paguheshin nese do te blinin te njejtin aktiv ose nje aktiv ekuivalent sot. Duke ju referuar detyrimit kosto aktuale eshte shuma e mjeteve monetare ose ekuivalenteve ne para te paskontuara qe mund te duhen per te pasur nje detyrim sot.
- *Vlera e realizueshme*, duke ju referuar aktivitet vlera e realizueshme eshte shuma e mjeteve monetare ose ekuivalenteve ne para te cilat mund te realizohen duke shitur aktivin me ane te nje shitje te organizuar. Duke ju referuar detyrimeve ekuivalentja e vleres se realizueshme eshte vlera e vendosjes, e cila perfaqeson shumen e mjeteve monetare ose ekuivalenteve ne para te paskontuara te cilat nevojiten per te permbushur detyrimet gjate nje kursi normal biznesi.
- *Vlera aktuale (brendshme)*, per nje aktiv eshte vlera aktuale, shuma e skontuar e gjithë flukseve hyrese te parase qe pritet te gjeneroje aktivitet gjate nje kursi normal biznesi. Duke ju referuar detyrimeve vlera aktuale eshte shuma e skontuar e gjithë flukseve dalese te parase qe pritet te paguhet per mbermbushjen e nje detyrimi gjate nje kursi normal biznesi.
- *Vlera e drejte* eshte shuma me te cilin nje aktiv mund te shkembet ose nje detyrim mund te vendoset, midis dy paleve te mireinformuara te cilat deshirojne te kryejne transakcionin. Kjo vlerë mund te perfshije ose vleren e tregut, ose vleren aktuale te aktivitet ose detyrimit.

Nga menyra si maten aktivitet dhe detyrimet e kompanise varet vlera neto e kapitalit te vet ose pasuria e askionereve.

2. Pasqyra e te ardhurave raporton performancen e firmes dhe shpjegon disa, por jo te gjitha, ndryshimet ne aktive, detyrime dhe kapital te vet te kompanise, midis dy bilanceve te datave te ndryshme.

Ndertimi i pasqyres se te ardhurave bazohet mbi dy parime kryesore:

- ✓ **Ne parimin rrjedhes**, i cili percakton qe te ardhurat dhe shpenzimet mund te njihen ne pasqyren e te ardhurave pavaresisht nese jane arketuar (ne rastin e te ardhurave) apo jane paguar ne rastin e shpenzimeve.
- ✓ **Ne parimin e pershatjes** i cili percakton qe te ardhurat dhe shpenzimet per realizimin e ketyre te ardhurave njihen ne te njejten periudhe kontabile.

Elementet e pasqyrave te te ardhurave perfshijne:

- **Te ardhurat** jane rritjet e perfitimeve ekonomike te cilat paraqiten ne formen e arketimeve ,rritje ne aktive, zvogelimet ne detyrime, dhe qe rezultojne ne rritje te kapitalit te vet (perves rritjes qe vjen si rezultat i kontributit te aksionereve).
- **Shpenzimet** jane uljet e perfitimeve ekonomike te cilat paraqiten ne formen e pagesave, ulje ne aktive ose rritje ne detyrime dhe qe rezultojne ne ulje te kapitalit te vet (pervec uljes qe vjen si rezultat i shperndarjeve tek aksioneret).

3. Pasqyra e fluksit te parase (Cash Flow) raporton flukset hyrese dhe dalese te klasifikuara si flukse nga aktivitetet operative, investimi dhe financimi. SFAC 95 i percakton keto Cash Flow si:

- **Flukse nga aktivitetet investimi** jane ato flukse qe rezultojne nga blerja apo shitja e prones, fabrikes dhe pajisje, te nje filiali apo segmenti biznesi dhe blerja ose shitja e investimeve ne firma te tjera.
- **Flukse nga aktivitetet financimi** jane ato flukse qe rezultojne nga emetimi ose shlyerja e borxhit, emetimi opo terheqja e kapitalit te vet si dhe dividendet e paguar aksionereve .
- **Flukset nga aktivitetet operationale** perfshijne efektet monetare te te gjitha transakcioneve qe nuk klasifikohen as aktivitetet investimi dhe as financimi.

4. Paqyra e ndryshimeve te kapitalit aksioner reflekton informacionin rreth ngritjeve dhe uljeve ne vleren neto te kompanise ose ne pasurine e aksionereve.

Duke respektuar konceptin e FITIMIT gjithperfshires kjo pasqyre paraqitet si me poshte:

Vlera kontabile e kapitalit te vet ne fillim (te zakonshem dhe te preferuar)

Transaksionet e aksioneve neto me aksioneret e zakonshem

+ Kapitali i paguar nga emetimi i aksioneve

- Aksionet e riblera dhe te vendosura ne aksionet e thesarit

Transaksionet e aksioneve te preferuar neto

- + Kapitali i paguar nga emetimi i aksioneve te preferuar
- Shlyerjet e aksioneve te perferuar
- + Ndryshimi ne fitimet e pashperndara
 - + Fitimi neto
 - Dividente te zakonshem
 - Dividente te preferuar
- ± Fitim i akumuluar dhe fitim tjetër gjithëperfishires

± Ndryshimi ne kompensimet e aksioneve te pafituara (te shtyra)

Vlera kontabile e kapitalit te vet ne fund (te zakonshem dhe te preferuar)

FITIMI gjithëperfishires eshte ndryshimi ne kapital te vet nga te gjithë transaksionet (kryesore dhe jo kryesore) duke perjashtuar burimet ekonomike qe vijne nga aksioneret.

Ajo perfshin te gjitha ndryshimet ne kapital gjate nje periudhe pervec atyre qe rezultojne nga investime nga aksioneret dhe shperndarje (terheqje) per aksioneret. Qellimi i konceptit te te ardhures gjithëperfishires eshte qe te ndihmoje ne dallimin e ndryshimit te te ardhurave neto nga operacionet e vazhdueshme nga te ardhurat e tjera qe vijne si rezultat i aktivitetëve jo operacionale.

Rezultatet e operacioneve te vazhdueshme, operacioneve jo te zakonshme ose jo te shpeshta, taksat, operacionet e nderprera, operacionet e jashtezakonshme dhe efektet e ndryshimeve kontabel raportohen vecante ne pasqyren tipike te te ardhurave. Megjithate, ne shume raste, klasifikimi i zerave te pasqyres eshte subjekt i zgjedhjes se drejtimit.

E. Shenimet shoqeruese te pasqyrave financiare

Shenimet shoqeruese te pasqyrave financiare perfshijne shpjegime qe ndihmojne per te kuptuar informacionin e permbledhur ne pasqyrat financiare. Shenimet shoqeruese kerkohen nga GAAP ose SEC per ta lejuar perdoruesin te permiresoje percaktimin e vlerave, te kohes dhe pasigurine e vleresimit te raportuar ne pasqyrat financiare.

- Ato gjithashtu sigurojne informacion rreth metodave kontabel dhe supozimeve dhe vleresimeve te perdorura nga drejtimi.
- Shenimet shoqeruese auditohen, ndersa shenime te tjera si planifikimet shtese nuk auditohen.
- Shenimet shoqeruese sigurojne informacion shtese ne zera te tille si aktive fikse, inventar, taksa mbi te ardhurat, pensione, obligacione, pasiguri dhe angazhime, fonde te tregtueshme, kliente te rendesishem, shitje paleve te lidhura dhe shitje ne eksport.

Shenimet shoqeruese shpesh pëmbajne shenime ne lidhje me humbjet e mundshme. Kompanive ju kerkohet te njohin nje humbje te mundshme kur: (1) ka mundesi qe aktivet te jene demtuar ose nje detyrim eshte shkaktuar; dhe (2) shuma e humbjes mund te vleresohet me perafersi te arsyeshme. Ne shenimet shoqeruse mund te percakohet nje kufi minimal dhe maksimal i humbjes se mundshme. Ne rastet kur eshte mjaft e mundur qe humbja te jete shkaktuar, atehere kerkohen shenimet shoqeruese te humbjes se mundshme.

F. Burime te tjera te informacionit te raportimit financiar

Pjesa e Diskutimit dhe Analizes se Manaxhimit (DM&A) siguron nje vleresim te performances dhe kushteve financiare te nje kompanie nga perspektiva e kompanise. MD&A kerkohet nga SEC (Security Exchange Commission).

1. Ne MD&A kerkohet diskutim mbi:

- Rezultatet e operacioneve, duke perfshire diskutimin e trendes ne shitje dhe shpenzime.
- Burimet kapitale dhe likuiditetet, duke perfshire diskutimin e trendes se Cash Flow.
- Nje shikim i pergjithshem i biznesit i bazuar ne trenden e njohur.

2. Elemente shtese perfshijne:

- Diskutimin e efekteve sinjifikante te trendes, ngjarjeve dhe pasigurive tashme te njohura (ku vullnetarisht mund te pershihen te dhena parashikuese, te dhena progresive).
- Burimet e likuiditetit dhe kapitalit dhe transaksionet ose ngjarjet ku perfshihet likuiditeti.
- Operacione te nderprera, zerat te jashtezakonshem, dhe ngjarje te tjera te pazakonshme ose jo te shpeshta.
- Shenime gjithepfshirese ne pasqyrat financiare te perkohshme.
- Shenime te nevojave te segmenteve te ndryshem per fluks parash ose kontribute ne te ardhurat dhe fitimet e kompanise.
- Ne menyre qe informacioni qe marrin investoret te jete i krahasueshem, gjate hartimit te pasqyrave financiare kompanite e vendeve te ndryshme perdorin standarte kontabile te njejta, te pranuar ne vendet ku ato ushtrojne operacionet.

Krahasueshmeria e pasqyrave financiare

Ne menyre qe informacioni qe marrin investioret te jete i krahasueshem, gjate hartimit te pasqyrave financiare kompanite e vendeve te ndryshme perdorin standarte kontabile te njejta, te pranuar ne vendet ku ato ushtrojne operacionet.

Ne U.S pasqyrat financiare pergatiten duke perdorur Principet Gjeresisht te Pranuar te Kontabilitetit (GAAP). Ne vendet zhvilluara, pasqyrat financiare pergatiten duke u bazuar ne Standartet Nderkombetare te Kontabilitetit, IASC.

Ne kushtet e globalizimit kur kompanite multinacionale duhet te perdorin standartet e vendin ku operojne dhe ne te njeten kohe te pershtaten me rregullat kontabile qe kerkohen ne vendin e kompanise meme, pergatitja e pasqyrave financiare eshte nje detyre e veshtire dhe e rendesishme.

Ne te njetjen kohe qe te krahasohen performancat e kompanive te ndryshme te cilat pergatisin pasqyra financiare te bazuara ne standarte te ndryshme, kerkohet rregullimi i pasqyrave ne te njejtin standart qe ato te behen te krahasueshme.

Literatura :

Chapter 1,2 :International Financial Statements Analysis , Robinson,CFA Van Greuning CFA, Henry CFA,Broihaan CFA Chapeter 1The Analysis and Use of Financial Statements, Gerald I. White Ashwinpaul C. Sondhi, Dov Feis 3rd ed.
--